

**Tiranë, më 13.6.2023**

### **Njoftim për shtyp**

Komisioneri Publik ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, ku vijoi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 629, datë 3.3.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besnik Cengu, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, vendosi:

1. *Ndryshimin e vendimit nr. 629, datë 3.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në këtë mënyrë:*
  - i. *Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, Besnik Cengu, me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.*
  - ii. *Në zbatim të pikës 2, të nenit G, të aneksit të Kushtetutës, ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cengu, për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.*
2. *Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.*

*U shpall sot, në Tiranë, më datë 13.6.2023.*

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: <http://ikp.al/ankime/>

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.